



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština- Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65.9 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 52 të Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar lidhur me Kartonin e gjelbër, në Seancën plenare të mbajtur më 4 dhe 5 qershor 2018, me propozim të deputetit Faton Topall dhe të harmonizuar edhe me grupet tjera parlamentare, nxjerr këto:

REKOMANDIME

1. Kuvendi i Kosovës mbështet Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që t'i koordinojë hapat mbikëqyrës dhe organizativë të institucioneve kompetente në vend, në radhë të parë të Bankës Qendrore të Kosovës, Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, me qëllim të zgjidhjes së shpejtë të çështjes në fjalë - duke mos përjashtuar zgjidhjet alternative deri në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe grupet punuese që derivojnë nga ai, ka për detyrë që t'i koordinojë dhe ndajë detyrat për institucionet relevante në vend; si dhe t'i përcaktojë veprimet konkrete brenda detyrave për secilin aktor.
3. BQK-ja në rolin e saj mbikëqyrës mbi Byronë e Sigurimeve të Kosovës të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës që deri më 30 qershor 2018 ta analizojë lartësinë e primit të Policës Kufitare për ta shikuar mundësinë e uljes së çmimit të saj prej datës 1 korrik 2018.
4. Brenda një muaji, Ministria e Punëve të Brendshme obligohet të dalë me plan veprues për reduktimin e automjeteve të paregjistruara që qarkullojnë brenda Republikës së Kosovës.
5. Brenda periudhës tremujore, Ministria e Punëve të Brendshme ta reduktojë numrin e automjeteve të paregjistruara nga 20% në 5%.
6. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe grupet punuese që dalin nga ai, më së largu deri më 1 dhjetor 2018 t'ia paraqesin Kuvendit raportin për ecurinë e angazhimeve të secilit institucion. Nëse deri atëherë nuk arrihet zgjidhje e përkohshme apo e përhershme për Kartonin e Gjelbër, t'ia paraqesë Kuvendit koston financiare të njohjes së njëanshme të Kartonit të Gjelbër - si dhe rekomandimin për këtë njohje.

Nr. 06- D0-687

Prishtinë, 05.06. 2018

Kryetari i Kuvendit


Kadri VESELI

Rekomandime u dërgohen:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština- Assembly

VI saziv
Prolečno zasedanje

Skupština Republike Kosova , shodno članu 65.9 Ustava Republike Kosova i člana 52. Poslovnika Skupštine, nakon debate u vezi Zelenog kartona, na plenarnoj sednici održanoj 4. i 5. juna 2018, na predlog poslanika Faton Topall, kao i usklađenih preporuka sa ostalim parlamentarnim grupama donela je sledeće:

P R E P O R U K E

1. Skupština Kosova podržava Komisiju za budžet i finansije, u svojstvu funkcionalne komisije, da koordiniše korake nadgledanja i organizacije nadležnih institucija u zemlji, kao prvo Centralnu banku Kosova, Kosovski biro za osiguranja, Ministarstvo unutrašnjih poslova , Ministarstvo finansija, u cilju brzog rešenja pomenutog pitanja-ne isključujući alternativna rešenja do učlanjivanja Kosova u Odbor biroa zelenog kartona.
2. Komisija za budžet i finansije, kao i radne grupe , imaju za cilj da koordinišu i podele zadatke relevantnim institucijama u zemlji; kao i da utvrde konkretne postupke u okviru zadataka za svakog aktera.
3. CBK-a u svojoj ulozi nadgledanja Biroa osiguranja Kosova da zahteva od Biroa da do 30. juna 2018 godine analizira visinu prima granične policije za razmatranje mogućnosti smanjenja iznosa od 1. jula 2018 godine.
4. U okviru mesec dana, MUP se obavezuje da izradi plan delovanja za smanjenje broja ne registrovanih vozila koja se kreću unutar Republike Kosova.
5. U okviru tromesečnog perioda MUP da reducira broj ne registrovanih vozila sa 20% na 5%.
6. Komisija za budžet i finansije i radne grupe najkasnije do 1. decembra 2018 godine da podnesu Skupštini izveštaj o ishodu angažovanja svake institucije. Ako se do tada ne pronađe privremeno ili stalno rešenje za Zeleni karton, da podnesu Skupštini finansijski trošak jednostranog priznavanja Zelenog kartona-kao i preporuke za to priznavanje.

Br. 06- D₂-687

Priština, 05.06. 2018

Predsednik Skupštine :

Kadri VESELI

Preporuke dostaviti:

- Vladi Republike Kosova,
- PG, i
- Arhivi Skupštine.